



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:278069
Datë: 23.01.2025
Numri i dokumentit: 06749232

Ca.nr.13827/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË–Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Enes Mehmeti kryetar i kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Ylber Shurdhiqi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.R., nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.SH., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2840/23, të datës 23.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.01.2025, jep këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditëses S.R., nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2840/23, të datës 23.09.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka vendosur si në vijim: *I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses S.R., nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitin 2020, në vlerën e shumës së pagës bazë prej 471.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës...*

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën e paditëses si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta

ndryshoj dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe ta vërtetoj vendimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 13.12.2023, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurave për kompensimin e pagës së 13-të, me detaje të tjera të përshkuara si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitat e nenit 399 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura, andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë dispozite ligjore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.*

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i provuar nga kontrata në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditëses dhe të paditurës, nr.04-1809 e dt.29.12.2016) dhe paga bazë e tij është 471.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018 – 10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13-të, justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Pra, barrën e të provuarit për mundësitë buxhetore e bart punëdhënësi.

Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023 të datës 09.10.2023.

Për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, gjykata ka administruar provën: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, i publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në faqen 20, pikën 3 shihet se është konstatuar se “në vitin 2020, Komuna e Gjilanit ka shpenzuar 93 % të buxhetit përfundimtar, ose 27,361.357 euro, me një ulje 1 % në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 15,929,937 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 15,816,156 euro.

Nga kjo konstatohet se për 113,781 euro, nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet.

Gjykata e shkallës së parë, faktin se e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore për këtë kompensim, gjykata e vërtetoi nga dokumentet e theksuara si më sipër, nga të cilat konstatoi se e paditura për vitin 2020 në kategorinë pagat dhe mëditjet sipas buxhetit final dhe atij të shpenzuar ka pasur suficit prej 113,781 euro.

Andaj, gjykata e shkallës së parë refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadiës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të

cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive". Me nenin 17 paragraf 2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018 përcaktohet se: "Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit." Andaj, në rastin konkret paditëses me të drejtë i është refuzuar shuma prej 471.00 euro në emër të pagës së 13-të për vitin 2020 nga punëdhënësi i fundit, në këtë rast e paditura, pasi që sipas njoftimit të të paditurës me, për vitin 2020 si dhe Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, vërtetohet se e paditura, nuk ka pasur mundësi buxhetore për pagesën e pagës së 13-të. Këtë fakt e mbështet edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (mendimi juridik për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të, të punëtorëve të shëndetësisë e dt.09.10.2023, faqja 2, pasuesi i fundit), ku përcaktohet se: Nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë.

Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për çka edhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ca.nr.13827/2024, me datë 23.01.2025

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Enes Mehmeti